



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE, STREHIMIT DHE SHËNDETIT PUBLIK

Nr. 20422/1 Prot

Shkodër, më 11 .12 .2019

Lënda: Kthim përgjigje

SHOQATËS “SHPRESA KUNDËR VERBËRISË”, SHKODËR

Për dijeni:

KËSHILLIT BASHKIAK ✓

I nderuar Z. _____,

Në vijim të kërkesës suaj, ju informojmë se Bashkia Shkodër, në zbatim të politikës së saj të zhvillimit : “Gjithëpërfshirja, pjesëmarrja dhe krijimi i mundësive të barabarta dhe mosdiskriminimit për shkak të aftësive të kufizuara, gjinisë, origjinës, minoritetit etj.”, në vitin 2016 ka filluar punën për krijimin e rrjetit të shërbimeve sociale komunitare.

Për herë të parë në vitin 2016 u ngritën qendrat komunitare “Për Familjen”. Këto qendra ofrojnë shërbime sociale si: informim, orientim, këshillim, shërbim në familje, mbështetje psikosociale, etj. për të gjitha kategoritë vulnerable si: fëmijë, të rinj, persona me aftësi të kufizuara, rom dhe egjiptian, të moshuar etj. Aktualisht janë në funksion të plotë 12 qendra komunitare “Për Familjen”, përkatësisht në 5 lagje të qytetit dhe në njësitë administrative Dajç, Gur i Zi, Velipojë, Rrethina dhe Postrinë.

Në vazhdim të krijimit dhe zgjerimit të rrjetit për ofrimin e shërbimeve sociale në territor është krijuar edhe Qendra e parë Rinore Publike dhe Qendra Multifunksionale “Për Familjen” në territorin e Bashkisë Shkodër.

Për ofrimin e shërbimeve pranë qendrave komunitare “Për Familjen” Bashkia e Shkodrës bashkëpunon me organizatat e shoqërisë civile, si partnere të rëndësishme në ofrimin e shërbimeve sa më cilësore dhe në përputhje me nevojat e komunitetit.

Në këtë kuadër, organizata juaj është e mirëpritur për të bashkëpunuar dhe ofruar shërbimet e saj në mbështetje dhe në ndihmë të personave të verbër, në këto qendra.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

KRYETAR
Voltana Ademi

